



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.05.2023

Nr: 167

Ora: 15:45

VENDIM

“PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 89, DATË 25.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA ‘PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET’”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti Zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, përfaqësuar nga z. Shkëlqim Sulo dhe z. Klardi Xhemali.

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr. 556, datë 23.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e bashkisë Delvinë, për zgjedhjet për organeve e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.



BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, neni 123/1, pika 1, neni 124, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN SE:

Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitet” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore objekt i këtij procedimi, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 89 regj., datë 25.05.2023.

Pas hedhjes së shortit, u zgjodh relator për shqyrtimin e çështjes z. Elvis Çefa. Në seancën paraprake të datës 29.05.2023, ora 12:55, KAS vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim në datën 30.05.2023, ora 15:30.

Gjatë seancës së shqyrtimit të datës 30.05.2023 në KAS, përfaqësuesi i subjektit ankues, z. Shkëlqim Sulo, deklaroi se heq dorë nga kërkesa e tij ankimore.

Në këto kushte, duke qenë se ankuesi ka hequr dorë tërësisht nga ankimi në këtë fazë të procedimit, në kuptim të nenit 142 të Kodit Zgjedhor, atëherë KAS duhet të vendosë pushimin e çështjes në tërësi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 89, datë 25.05.2023, të paraqitur nga “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot në datë 30.5.2023

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**